

RELACION



PËR

**PROJEKTLIGJIN “PËR DISA NDRYSHIME NË LIGJIN NR. 10 465,
DATË 22.9.2011, “PËR MENAXHIMIN E INTEGRUAR TË MBETJEVE”,
TË NDRYSHUAR**

**I. QËLLIMI I PROJEKTAKTIT DHE OBJEKTIVAT QË SYNOHEN
TË ARRIHEN**

Një nga angazhimet madhore të programit politik qeverisës, i parë në përputhje edhe me objektivat kushtetues të zhvillimit të qëndrueshëm të vendit, është ruajtja dhe krijimi i një mjedisi të shëndetshëm dhe ekologjikisht të përshtatshëm përbrezat e sotëm dhe të ardhshëm. Krijimi dhe ruajtja e një mjedisi të tillë, garantimi i standardeve të zhvilluara mjedisore, shfrytëzimi i burimeve natyrore mbi bazën e parimit të zhvillimit të qëndrueshëm, janë angazhimi programor dhe detyrim moral ndaj së tashmes dhe së ardhmes sonë të përbashkët.

Ndër objektivat e Strategjisë dhe Planit Kombëtar të Menaxhimit të Mbetjeve është riciklimi i mbetjeve. Në këtë kuadër shumë investitor të huaj dhe vendas kanë investuar në industrinë e riciklimit të mbetjeve, duke filluar para se kjo strategji të miratohej, bazuar në legjislacionin në fuqi, i cili lejonte importin e mbetjeve të ngurta me qëllim riciklimi, ripërdorimi dhe përpunimi.

Gjithashtu me miratimin e ligjit nr. 10 463, datë 22. 09. 2011, “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve”, në nenin 49 lejohej importi i mbetjeve me qëllimin e sipërcituar.



Nisur sa më sipër u ngrit industria e riciklimit, e cila përfaqësohet nga Shoqata e Ricikluesve të Shqipërisë. Investimet në këtë fushë zënë rreth 120 milion Euro dhe janë të punësuar rreth 35.000 punonjës. Investimet ishin llogaritur, që përveç riciklimit të mbetjeve që gjenerohen në vend, të perfshiheshin edhe një pjesë nga importi. Këto ishin të përcaktuara qartë në dy VKM, të cilat përcaktonin procedurat dhe rregullat, si dhe listën e mbetjeve që lejoheshin, bazuar në listën e gjelbërt të BE.

Me miratimin e ligjit nr. 156, datë 10.10.2013, "Për disa ndryshime në ligjin nr. 10463, datë 22.09.2011, "për menaxhimin e integruar të mbetjeve u ndalua importi i mbetjeve, duke arsyetuar se institucionet përkatëse nuk ishin në gjëndje të inspektonin dhe kontrollonin cilësinë e mbetjeve. Kjo për mungesë të kapaciteteve dhe laboratorëvë përkatës.

Ndalimi I importit solli si pasoje që industria e riciklimit të punoj me 30 % të kapaciteteve, duke i shkaktuar një dëm të madh ekonomik, si dhe shkurtim të fuqisë punetore.

Aktualisht, gjatë këtyre tre vjetëve, në këtë drejtim janë bërë përmirësimë të dukshme. Kemi një rinnovim të Inspektoriatit të Mjedist, si në infrastrukturën përkatëse (e cila i mungonte), ashtu edhe në trajnimin e personelit si brënda dhe jashtë shtetit. Agjensia Kombëtare e Mjedisit është pajisur me një laborator, i cili kryen analiza të ndryshme, dhe në rastet kur ai nuk ka mundësi ti kryej ato i bën në laborator privat të specializuar dhe akredituar për këtë qëllim.

Gjithashtu edhe në doganë ka përmirësimë si në infrastruktur dhe në personel të trajnuar.

Nënshtimi i këtyre mbetjeve ndaj analizave specifike të përbërjes dhe rrezikshmërisë së tyre, eliminon mundësinë e rrezikut të futjes së mbetjeve të rrezikshme në RSH, duke shtuar kështu edhe rrezikshmërinë për jetën dhe shëndetin e njerëzve.

Duhet thënë se edhe në relacionin shoqërues të ligjit **nr. 156, datë 10.10.2013**, "**Për disa ndryshime në ligjin nr. 10463, datë 22.09.2011, "për menaxhimin e integruar të mbetjeve", të ndryshuar**, është cituar : amendamentet e propozuara do të jenë në formën e dispozitave tranzitore me afat jo më tepër se 2 vite nga miratimi, pasi synojmë që marrja e masave të nevojshme dhe mirorganizimi, bashkëpunimi me qeverisjen vendore, do sjelli efektet e synuara në miratimin e ligjit.

Ndryshimet e ligjore te propozuara, pasuar nga aktet e tjera nenligjore do ti hapnin rrugen implementimit te plote te direktives **No 1013/2006 OF THE EUROPEAN PARLIAMENT AND OF THE COUNCIL per qarkullimin e mbetjeve**.

Ne kete menyre do te kemi standarte europiane ne ne gjithe ciklin e qakullimit te mbetjeve, nga gjeneruesi, eksportuesi, transportuesi importuesi dhe ricikluesi final I ketyre mbetjeve. Kjo gje do te garantonte zinxhirin transparent te gjurmueshmerise per te gjithe aktoret e interesuar.

Ndryshimet ligjore te propozuara gjithashtu do te mundesonin plotesimin e një prej kritereve te integrimit, te nenvizuar si te e paplotesar ne raport progresin e fundit te BE.

Me tej, ndyshimet ligjore do te hapnin mundesi te medha ekonomike ne sektorin e riciklimit shoqeruar me krijimin e dhjetra mijë vende te reja pune, rritje te rendesishme te GDP dhe dyfishimin e eksporteve, referuar nga Shoqata e

Ricikluesve.

Ndryshimet ligjore do ti sherbenin fuqizimit te kapaciteteve te industries se riciklimit, qe ti paraprije nevojes ne rritje per perpunim te mbetjeve te riciklueshme te vendit, pas implementit te reformes territoriale.

Me qëllimi I këtij alkti është pikërisht rilejimi I importit të mbetjeve jot ë rrezikshme në territorin e Republikës së Shqipërisë duke rivitalizuar kështu industrinë e riciklimit në vënd.

II. VLERËSIMI I PROJEKTAKTIT NË RAPORT ME PROGRAMIN POLITIK TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, ME PROGRAMIN ANALITIK TË AKTEVE DHE DOKUMENTE TË TJERA POLITIKE

Akti i propozuar, nuk ka qënë i parashikuar në programin analistik të akteve të Ministrisë së Mjedisit, pasi për të miratuar një akt të tillë janë dashur të bëhen një sërë investigimesh pranë doganave të vëndit dhe pranë impjanteve të riciklimit të mbëtjeve në vënd.

III. ARGUMENTIMI I PROJEKTAKTIT LIDHUR ME PËRPARËSITË, PROBLEMATIKAT, EFEKTET E PRITSHME

Përparësitë e aktit janë tre kryesoret:

- a. Akti do të rivitalizojë dhe do të vërë 100% në eficencë industrinë vëndase të riciklimit të mbetjeve
- b. Rihapje e shumë vëndeve të punës të mbyllura si pasojë e ndryshimit ligor
- c. Transpozim më i plotë i Direktives No 1013/2006 OF THE EUROPEAN PARLIAMENT AND OF THE COUNCIL per qarkullimin e mbetjeve, pasi ligji 156/2013 ishte në kundështim me këtë akt.

Nuk mendojë se miratimi i aktit mund te sjellë problematika në vënd por mendojmë se do të sjellë vetëm efekte pozitive si pasojë e përparësive të sipërcituara.

IV. VLERËSIMI I LIGJSHMËRISË, KUSHTETUTSHMËRISË DHE HARMONIZIMI ME LEGJISLACIONIN NË FUQI VENDAS E NDËRKOMBËTAR

Akti i propozuar është në harmoni të plotë me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë dhe me të gjithe legjislacionin në fuqi vëndas dhe të huaj.

V. VLERËSIMI I SHKALLËS SË PËRAFRIMIT ME *ACQUIS COMMUNAUTAIRE* (PËR PROJEKTAKET NORMATIVE)

Akti i propozuar bën një përafrim më të plotë të Direktives No 1013/2006 OF THE EUROPEAN PARLIAMENT AND OF THE COUNCIL per qarkullimin e mbetjeve, pjesa tjeter e të cilës është përafruar me ligjin nr. 10 463, datë 22.9.2011 “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve” të ndryshuar.

VI. PËRMBLEDHJE SHPJEGUESE E PËRMBAJTJES SË PROJEKTAKIT

Akti i propozuar rikthen të drejtën e importit të mbetjeve jo të rrezikshme në vënd. Ai i rikthen të drejtat që ka patur Këshilli i Ministrave si pjesë e rrjetit të integruar të mbetjeve. Gjithashtu, Ai përcakton autoritetin pranë të cilit depozitohet kërkesa për importin e mbetjeve si dhe autoritetin që e lëshon këtë akt. Si pasojë e këtij parashikimi, bëhen edhe ndryshimet përkatëse në pjesën takuese të kundërvajtjeve administrative me qëllim që mbetjet jo të rrezikshme të mos importohen pa u pajisur me dokumentacionin përkatës që specifikohet në këtë akt.

Akti i propozuar parashikon daljen e një Vendimi të Këshillit të Ministrave, e ashtuquajtura “lista e gjelbër”, ose sic mund te thuhet ndryshe lista e mbetjeve që mund të importohen në Republikën e Shqipërisë, pasi akti që ka qënë në fuqi

për këtë qëllim është shfuqizuar me Ligjin nr. 156/2013. Miratimi i këtij akti do të realizojë fillimin e implementimit të këtij akti që propozojmë.

VII. INSTITUCIONET DHE ORGANET QË NGARKOHEN PËR ZBATIMIN E AKTIT

Për zbatimin e këtij akti ngarkohet Ministria e Mjedisit.

VIII. PERSONAT DHE INSTITUCIONET QË KANË KONTRIBUAR NË HARTIMIN E PROJEKTAKTIT


Akti është hartuar nga Ministria e Mjedisit, në bashkëpunim me Shoqatën e Ricikluesve në vend dhe me Komisionin për Veprimtaritë Prodhuese në Kuvendin e Republikës së Shqipërisë.

IX. RAPORTI I VLERËSIMIT TË TË ARDHURAVE DHE SHPENZIMEVE BUXHETORE

Akti I propozuar nuk parashikohet të këtë asnjë efekt shtesë në buxhetin e shtetit për Ministrinë e Mjedisit, ndërkohë që lejimi I importit të mbetjeve do të rrisë të ardhurat në buxhetin e shtetit si pasojë e detyrimeve doganore që do detyrohet të paguajnë në doganë importuesit e këtyre mbetjeve.

GRUPI I DEPUTETËVE PROPOZUES:

1. EDUARD SHALSI



2. Ervin Bushati

3. Bujar Devumi

4.

5.

6.

7.

8.

9.

10.

11.

12.

13.

14.

15.

16.